



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 67 Prot.

Tiranë, më 15.01 2019

**VENDIM Nr. 1, datë 15.01.2019**

Në mbështetje të **Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë"**, Neni 134, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 1, datë 15.01.2019, pasi shqyrtoi Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të **projektit "Rikualifikimi i Akseve rrugore Unaza Lindore Loti 2"**, Bashkia Tiranë-subjekti Autoriteti Rrugor Shqiptar, realizuar nga individët e licencuar në arkeologji Z. Neritan Ceka dhe Z. Skënder Muçaj,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të **projektit "Rikualifikimi i Akseve rrugore Unaza Lindore Loti 2"**, Bashkia Tiranë-subjekti Autoriteti Rrugor Shqiptar, realizuar nga individët e licencuar në arkeologji Z. Neritan Ceka dhe Z. Skënder Muçaj.
2. Subjekti Autoriteti Rrugor Shqiptar duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje tre palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili duhet të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të gërmimit për projektin "Rikualifikimi i Akseve rrugore Unaza Lindore Loti 2", Bashkia Tiranë, si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të mbikëqyrë këtë subjekt.
3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10.2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR  
MIRELA KUMBARO TURXHI  
MINISTËR



SEKRETAR I KKA  
RUDINA ZOTO

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al